

Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K., është Institucion Mikrofinanciar i cili me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit ka planifikuar mbajtjen e trajnimit si më poshtë.

SHPALLJE

Në bazë të kësaj shpallje ftohen kompanitë/individët e interesuara për paraqitjen e ofertave të tyre për mbajtjen e trajnimit sipas temave dhe kushteve të specifikuar në vijim.

Objekti i shpalljes: Mbajtja e trajnimeve me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit.

Nr	Titulli i trajnimit	Përshkrim i llojit të trajnimit	Grupi i synuar	Numri i grupeve	Numri i pjesëmarrësve në grup	Kohëzgjatja në ditë për grup	Numri total i ditëve
1	Trajnim bazik për Analist Kreditor të ri	Marketing, analizë financiare, menaxhim i rrezikut, raste studimi, etj.	Analist kreditor	1	12-15	2	2
2	Trajnim në vend të punës për Analist Kreditor të ri	Promovim, analizë financiare, komunikim me klientë, komiteti kreditor etj.	Analist kreditor	5	3-4	1	5

Oferta për aplikim duhet të përmbajë:

1. Të dhënat për kompaninë/institucionin/individin (mbajtësi i trajnimit),
2. Të dhënat kontaktuese (adresën elektronike, numrin e telefonit, webfaqe, etj),
3. Detaje rreth modulit të trajnimit,
4. Referencat për punë të ngjashme (të preferuara ato nga sektori financiar)
5. Certifikata e kompanisë nëse ofertuesi është person legal,
6. Të dhënat për trajnerët (CV-të), përfshirë certifikatat që dëshmon se është i certifikuar si trajner apo ka pervojat relevante në fushat përkatëse,
7. Oferta financiare dhe afati për kryerjen e punës si me lartë (e preferushme nga muaji Maj)
8. Çmimet duhet të jenë me TVSH dhe për ditë të trajnimit.
9. Trajnimet janë parapare të mbahen në klase dhe në zyrat e degeve të KRK-s.

Afati i dorëzimit të ofertave: nga dt. **24.04.2023 deri 03.05.2023**. Afati i implementimit të trajnimeve: Maj-Qershor 2023

Kompanitë e interesuara mund t'i dërgojnë ofertat e tyre në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com apo në zyrën e KRK, Rr.Behije Dashi Nr. 20, Prishtinë. Nëse keni nevojë për sqarime shtesë mund të na shkruani në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com. Zgjedhja e kompanisë/institucionit/individit (mbajtësi i trajnimit) fitues do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofertave nga komisioni duke marrë në konsiderim kualitetin, çmimin dhe afatin e propozuar për mbajtjen e trajnimeve.

Titulli i email-it tuaj duhet të përmbajë mbishkrimin “Aplikim për trajnime”